

VENDIM
Nr. 176, datë 7.7.2022

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 144, DATË 6.6.2022, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË ‘BLAC ENERGY’ SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
157, DATË 9.7.2018”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 7, 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/1 prot., datë 30.6.2022, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 6.6.2022, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.

- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “Blac Energy” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2021 për licencën në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me mos zbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 515/1 prot., datë 10.6.2022, shoqëria është njoftuar për vendimarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer më datë 20.6.2022.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t’i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës, në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet, se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast, “qëllimi” i procedurës, lidhet ngushtësisht me marrjen e masave administrative, kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimarrjen. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të

rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% të vlerës së debisë nga shoqëria “Blac Energy” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës së prapambetur, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje, Bordi do të vendosë, për: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Blac Energy” sh.p.k për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti